



REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA GRAMSH
KËSHILLI BASHKIAK

PROCESVERBAL

Mbledhja e radhes e Këshillit Bashkiak Muaji GUSHT mbajtur sot me datë 29/08/2025 ora 10:00 në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak.

Në mbledhje marrin pjesë 13 këshilltarë: Enis Zani, Luljeta Dollani, Ardina Hasa, Fatbardh Cekrezi, Greta Lena, Dalip Hazizaj, Kodhel Cala, Kujtim Brahimi, Valbona Verushi, Visarion Bici, Alketa Bici, Erald Carciu, Brunilda Gjevori.

Mbledhja drejtohet nga Kryetari i Këshillit z. Enis Zani.

Merr pjesë në mbledhje Kryetari i Bashkisë, z. Besion Ajazi.

Në zbatim të Nenit 192 të rregullores së Këshillit Bashkiak; "Kryetari i Bashkisë ka të drejtë të ftojë stafin e tij në mbledhjet e Këshillit, për të dhënë shpjegime juridike dhe ligjore për projekt vendimet e paraqitura nga ekzekutivi në mbledhjen e Këshillit"; asistuan në mbledhje disa prej drejtorëve dhe përgjegjës të drejtorive përkatëse që dorëzuan projekt vendimet dhe relacionet.

E.Zani: Pershendetje, dua të shpreh mirënjohjen në emër të këshillit të gjithë forcave zjarrefikese dhe njerëzve vullnetarë që ndihmuan në shuarjen e zjarrit. Ne do të jemi përherë mbështetje për të gjithë banorët e prekur.

Kemi 8 pika në rend dite, kemi edhe një material shtesë që propozon bashkia për ta futur në rend dite, por duke qenë se për momentin nuk plotësohet kurumi i kërkuar do të shtyjme këtë pikë.

L.Dollani: Propozoj që nëse në vazhdim të mbledhjes bëhet kurumi ta fusim këtë pikë në rend dite.

E.Zani: Jeni dakort?

Unanimisht këshilltarët shprehin dakortësi nëse bëhet kurumi të futet materiali që propozon bashkia.

E.Carciu: Mendoj që duhet të ishte në rend dite një pikë me informacion lidhur me gjithë demet që u shkaktuan nga zjarret.

K.Bashkisë: Mund të besh një kerkese Erald dhe ta japim gjithë informacionin.

L.Dollani: Me rëndësi është që bashkia ka qenë në gatishmëri maksimale.

E.Zani: Hedhim në votim rendin e ditës?

***Miratohet rendi i ditës me 13 Vota PRO.**

Vota Kunder

Nuk ka Vota Abstenim

Sekretari Këshillit
Xhulia Gjini



Adresa: Sheshi "Kamber Dermyshe" Bulevardi "10 Korriku" Tel.Fax:0513 2 2272 E-mail:bashkiagramsh@gmail.com

Çështja 1

1- Për dhenien e ndihmes ekonomike per muajin Korrik 2025 (Fondi 6%).

Në mbledhje marrin pjesë 13 këshilltarë: Enis Zani, Luljeta Dollani, Ardina Hasa, Fatbardh Cekrezi, Greta Lena, Dalip Hazizaj, Kodhel Cala, Kujtim Brahimi, Valbona Verushi, Visarion Bici, Alketa Bici, Erald Carciu, Brunilda Gjevori.

Pergj.Ndh,Ek.: Per muajin Korrik kemi 31 familje te gjeneruara nga sistemi elektronik per perfitim .Ju ftoj qe materialin, ta votojme.

E.Carcu: Ka mundesi te futen familjet e prekura nga zjarret?

Pergj.Ndh,Ek.: Nuk kemi te drejte ta kalojme fondin te familjet e prekura.

E.Zani: Votojme?

***Miratohet pika 1 e rendit te ditës me 13 Vota PRO**

Nuk Ka vota Kunder

Nuk ka Vota Abstenim

Sekretari Këshillit
Xhulia Gjini



Adresa: Sheshi "Kamber Dermishi" Bulevardi "10 Korriku" Tel/Fax: 0513 2 2272 E-mail: bashkiagramsh@gmail.com

Çështja 2

2- Mbi Planin Social për Bashkinë Gramsh.

Në mbledhje marrin pjesë 13 këshilltarë: Enis Zani, Luljeta Dollani, Ardina Hasa, Fatbardh Cekrezi, Greta Lena, Dalip Hazizaj, Kodhel Cala, Kujtim Brahimi, Valbona Verushi, Visarion Bici, Alketa Bici, Erald Carciu, Brunilda Gjevori.

Pergj.Ndh,Ek:. Sipas ligjit 121/2016 lind nevoja për të hartuar një Plan të ri Social, duhen identifikuar nevojat, bëhet vlerësimi i nevojave në baze të hartës së vulnerabilitetit me pa hartohet buxheti. Planet duhet të miratohen Brenda 1 shtatorit. Bashkia ka mbledhur të gjitha të dhënat në bashkëpunim me institucionet, nepermjet thirrjeve do të kemi të drejtë të aplikojmë që të kemi sa më shumë përfitime. (Vazhdon shpjegimi planit).

E.Zani : Keni pyetje? Votojme?

K.Cala: Cili është kushti që bashkia të bëhet pjesë e programit?

Pergj.Ndh,Ek:. Ne kemi 3 vite që jemi pjesë, ka përfunduar afati për planin të 1-re dhe lind nevojat bëhet plani i ri.

E.Zani: Votojme?

Miratohet pika 2 e rendit të ditës me 13 Vota PRO.

Nuk ka Vota Kunder

Nuk ka Vota Abstenim

Sekretari Këshillit
Xhulia Gjini



Adresa: Sheshi "Kamber Dermishi" Bulevardi "10 Korrik" Tel/Fax: 05/3 2 2272 E-mail: bashkiagramsh@gmail.com

Çështja 3
(Pika 4 ne rend dite)

- 3- Për miratimin e projekt marrëveshjes për krijimin e personit juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta midis njësive të vëetëqeverisjes vendore dhe Këshillit të Ministrave për rritjen e kapaciteteve të Qeverisjes Vendore të Shqipërisë (TALGA).

Në mbledhje marrin pjesë 13 këshilltarë: Enis Zani, Luljeta Dollani, Ardina Hasa, Fatbardh Cekrezi, Greta Lena, Dalip Hazizaj, Kodhel Cala, Kujtim Brahimi, Valbona Verushi, Visarion Bici, Alketa Bici, Erald Carciu, Brunilda Gjevori.

Sek.Pergj.Bashkise: Arsyeja e kesaj kerkese nga te dhenat qe jane marre, punonjesit ne administrate jane te shumte ne numer. Synimi eshte aderimi ne BE, dhe nevojitet nje trajnim specifik I administrates , lind nevoja e krijimit ten je personi juridik =====. Ministri I Pushtetit Vendor eshte personi qe do te merret me krijimin e ketij Personi Juridik. Bashkia Gramsh me VKB 38 ka miratuar fond per te qene pjese e kesaj, por synojme te perfitojme grantin e performances. Kerkojme te miratohet ne parim krijimi I ketij Personi Juridik.

K.Cala: Kjo structure juridike me kompetenca te pavarura, me funksion trajnimit e administrates shtetore, mendoj qe eshte me teper per tja kufizuar kompetencat administrates. Keto do jene ne varesi te qeverise . Per mendimin tim nuk eshte e pavarur.

Sek.Pergj.Bashkise: Spas VKM , Ministri I Pushtetit Vendor ka autorizim vetem per krijimin e Personit Juridik, dhe financimi 50% nga qeveria per 3 vite, me pas qeveria largohet.

V.Verushi: Cfare na siguron cilesine?

Sek.Pergj.Bashkise: Kemi mbeshtetjen e Zvicres, Suedise..

E.Zani: Une mendoj qe trajnimet jane te nevojshme gjithmone. Votojme?

***Miratohet pika 4 e rendit te ditës me 12 Vota PRO**

Vota Kunder: 1 , Kodhel Cala

Nuk ka Vota Abstenim

Sekretari Këshillit
Xhulia Gjini



Adresa: Sheshi "Kamber Dermyshe" Bulevardi "10 Korriku" Tel.Fax 0513 2 2272 E-mail: bashkiagramsh@gmail.com

Çështja 4
(Pika 3 ne rend dite)

4- Për miratimin e Planit të Arsimit Parauniversitar të bashkisë Gramsh 2026-2028.

Në mbledhje marrin pjesë 13 këshilltarë: Enis Zani, Luljeta Dollani, Ardina Hasa, Fatbardh Cekrezi, Greta Lena, Dalip Hazizaj, Kodhel Cala, Kujtim Brahimi, Valbona Verushi, Visarion Bici, Alketa Bici, Erald Carciu, Brunilda Gjevori.

I.Basha: Hartimi i këtij plani vjen si domosdoshmeri e performances te bashkise dhe gjithë nevojave te evidentuara. Kerkojme miratim sin je plan fillestar, kemi nxjerre ato perparesi qe i mendojme te nevojshme. Ligji 139/2015 paraqet detyrimet qe ka pushteti vendor, kemi zgjidhur disa objektiva qe i kemi pare te mundshme.

V.Verushi: E kemi pare planin du ate shihet pak pjesa e konviktit, aty do te ishte mire te ishte nje mesues. Me nje bashkepunim duhet rregulluar struktura e personelit.

K.Bici: Ky bashkepunim eshte, thjesht duhet te behet nje grafik sepse mesuesi I keto ore per te qene prezent.

I.Basha: Ne jemi nje bashki me nje shtrirje te madhe gjeografie dhe me nr te madh institucionesh arsimore, qe kane gjithmone vend per permiresim.

E.Zani: Votojme?

***Miratohet pika 3 e rendit te ditës me 13 Vota PRO**

Nuk Ka vota Kunder

Nuk ka Vota Abstenim

Sekretari Këshillit
Xhulia Gjini



Adresa: Sheshi "Kamber Dermyshe" Bulevardi "10 Korriku" Tel/Fax: 0513 2 2272 E-mail: bashkiagramsh@gmail.com

Çështja 5

- 5- Për miratimin e dokumentacionit për aplikim për bursë sipas kritereve të përcaktuara në VKM 666, datë 10.10.2019 i ndryshuar, për nxënësit në sistemin arsimor parauniversitar me kohë të plotë dhe arsimin e mesëm profesional.

Në mbledhje marrin pjesë 13 këshilltarë: Enis Zani, Luljeta Dollani, Ardina Hasa, Fatbardh Cekrezi, Greta Lena, Dalip Hazizaj, Kodhel Cala, Kujtim Brahimi, Valbona Verushi, Visarion Bici, Alketa Bici, Erald Carciu, Brunilda Gjevori.

K.Hasa: Miratimi i nje akti normative mbi listen e dokumentacionit qe dorezon nxenesi aplikues per burse sipas kritereve dhe kategorive te nxenesve sipas VKM 666 dt 10.10.2019 I ndr. Synon te siguroje: transparence dhe trajtim te barabarte per te gjithë aplikuesit, te lehtësoje procesin e verifikimit nga strukturat pergjegjese, te parandaloje abuzimet dhe reduktoje pasaktesine ne aplikime. (vazhdon shpjegon dokumentat qe duhen per aplikim sipas materialit).
E.Zani: Jeni te qarte? Keni pyetje? Votojme?


***Miratohet pika 5 e rendit te ditës me 13 Vota PRO**

Nuk Ka vota Kunder

Nuk ka Vota Abstenim


Sekretari Këshillit

Xhulia Gjini



Kryetari Këshillit

Enis Zani



Adresa: Sheshi "Kamber Dermyshe" Bulevardi "10 Korriku" Tel.Fax:0513 2 2272 E-mail:bashkiagramsh@gmail.com

Çështja 6

- 6- Për një ndryshim të vendimit të Këshillit të Bashkisë nr.8 datë 30.01.2025 "Për një shtesë në listën e inventarit dhe kalimin në pronësi të Bashkisë Gramsh të pronës me ZK "Truall" me nr 7/16 me vendodhje në qytetin Gramsh e cila do përdoret për interes vendor.

Në mbledhje marrin pjesë 13 këshilltarë: Enis Zani, Luljeta Dollani, Ardina Hasa, Fatbardh Cekrezi, Greta Lena, Dalip Hazizaj, Kodhel Cala, Kujtim Brahimi, Valbona Verushi, Visarion Bici, Alketa Bici, Erald Carciu, Brunilda Gjevori.

Pergjaseteve vendore: Nga korrespondenca me Agjensine Shtetërore të Kadastres Drejtorine e Pronave Shtetërore lind nevoja për një ndryshim të vendimit dhe specifikimin e funksionit/fushës së përdorimit, dhe kërkohej ndryshim në formulim të kërkesës : nga kërkohet miratim i kërkesës për transferim të pronës me nr pasurie 7/16 me status juridik "shtet" e cila ndodhet në Gramsh, për ta përdorur për interes vendor , në kërkohet miratim i kërkesës për transferim të pronës me nr pasurie 7/16 me status juridik "shtet" e cila ndodhet në Gramsh, për ta përdorur për "Pike e trajtimit të mbetjeve të gjelberta dhe të riciklueshme për ekonominë qarkulluese. Procedurat do të vazhdojnë me tej në Këshillin e Ministrave por paraprakisht kërkohej miratimi nga ana juaj.

E.Zani: Keni pyetje? Votojme?

***Miratohet pika 6 e rendit të ditës me 13 Vota PRO**

Nuk Ka vota Kunder

Nuk ka Vota Abstenim

Sekretari Këshillit
Xhulia Gjini



Adresa: Sheshi "Kamber Dermyshe" Bulevardi "10 Korriku" Tel.Fax:0513 2 2272 E-mail:bashkiagramsh@gmail.com

Çështja 7

7- Për miratimin e themelimit të shoqërisë sportive "Klubi i futbollit të femrave Gramshi.

Në mbledhje marrin pjesë 13 këshilltarë: Enis Zani, Luljeta Dollani, Ardina Hasa, Fatbardh Cekrezi, Greta Lena, Dalip Hazizaj, Kodhel Cala, Kujtim Brahimi, Valbona Verushi, Visarion Bici, Alketa Bici, Erald Carciu, Brunilda Gjevori.

Dr. Burimeve Njerezore: Aktualisht ligji për sportin njih disa forma të krijimit të veprimtarisë të ekipit të futbollit. Në qytetin tonë organizohet në kuadër të një shoqate jofitimprurëse, për të siguruar një menaxhim profesional dhe transparencë, financiarisht të pavarur të ekipit të futbollit të femrave propozojmë kalimin e veprimtarisë në një shoqëri aksionere të vecantë, forme ligjore që i lejon klubit të krijojë partneritete publike dhe private, të përfitojë fonde dhe sponsorizim dhe të ketë akses në projektet e FSHF. Shoqëria aksionere do të ketë si aksioner themelues Bashkia Gramsh me mundësi që në të ardhmen të përfshijë partnerë privat sipas VKB. Për kërkohej të miratohet themelimi i shoqërisë sportive "Klubi i futbollit të femrave "KFF Gramshi" sh.a në formën e një shoqërie aksionere me oferte private. Kërkohej miratimi i aktit të themelimit të kësaj shoqërie. Aksioner i vetëm dhe zotëruar 100% i aksioneve është Bashkia Gramsh. Kapitali themelues i shoqërisë është 35 mln leke. Kryetari i Bashkisë do të jetë përfaqësuesi KFF Gramsh në gjithë mbledhjet që do zhvillojë Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë. Pas regjistrimit të shoqërisë tregtare do fillojë regjistrimi i kësaj shoqërie si anëtar i FSHF.

K.Cala: Gramshi se ka luksin për krijimin e një klubi për femra, në nuk kemi as sportiste do i blejmë dhe kjo është kosto. Unë nuk jam dakort.

F.Cekrezi: Parimisht materiali duhet të ishte edhe më i plotë.

K.Bashkisë: Klubi i futbollit për femra po kalon nga shoqate në ShA sepse ka patur interes për aksionere, aktualisht kemi kërkesë nga një shoqëri angleze.

V.Verushi: E rëndësishme është që anëtarët të jenë nga Gramshi.

K.Bashkisë: Është viti 3-të që i them mesuesve të fiskultures të shohin vajza që kanë talent. Në jemi në nivelin e superligës.

V.Bici: Ka qytete më të vogla se ne që e mbajnë futbollin.

E.Carciu: Për mua është një nismë e mirë duhet investuar për rininë.

E.Zani: Si do shiten aksionet?

K.Bashkisë: Me ankand, nga bashkia.

E.Zani: Le të vendoset si kusht hapja e një akademie, qoftë për të stimuluar me një pagesë të vogël.

K.Bashkisë: Në mund të negociojmë por nuk detyrojmë dot aksionerët.

E.Zani: Hedhim në votim?

***Miratohet pika 7 e rendit të ditës me 13 Vota PRO**

Nuk Ka vota Kunder

Nuk ka Vota Abstenim

Sekretari Këshillit
Xhulia Gjini

Kryetari Këshillit

Enis Zani

Adresa: Sheshi "Kamber Dermishi" Bulevardi "10 Korriku" Tel.Fax: 0513 2 2272 E-mail: bashkiagramsh@gmail.com



Çështja 8

8- Kërkesa të qytetarëve ;Të tjera

Në mbledhje marrin pjesë 13 këshilltarë: Enis Zani, Luljeta Dollani, Ardina Hasa, Fatbardh Cekrezi, Greta Lena, Dalip Hazizaj, Kodhel Cala, Kujtim Brahimi, Valbona Verushi, Visarion Bici, Alketa Bici, Erald Carciu, Brunilda Gjevori.

Sek.Këshillit: Komisioni i Shëndetsisë u mbledh për të shqyrtuar kërkesat që paraqesin problematika shëndetësore. Bazuar në dokumentacionin që shqyrtuan si dhe kriteret e vendosura me VKB lidhur me keto raste, komisioni doli me raport dhe propozon 3 raste që Këshilli të miratojë: Kërkesa e z.Besnik Lazi (nr.2271 Prot. Date 13.06.2025), kërkesa z.Dylber Dermyshe (Nr.2738 Prot. Date 10.07.2025) dhe z.Hasan Ajazi (nr.1271 Prot. Date 27.03.2025).
E.Zani: Propozoj të jepet nga 50000 leke secilit, duke qenë se jemi në limit të fondit.
Hedhim në votim?

***Miratohet pika 8 e rendit të ditës me 13 Vota PRO**
(Miratohen të 3-j kërkesat me sipër)
Nuk ka vota Kunder
Nuk ka Vota Abstenim

Sekretari Këshillit
Xhulia Gjini

Kryetari Këshillit
Enis Zani













Adresa: Sheshi "Kamber Dermyshe" Bulevardi "10 Korrik" Të. Fax: 0913 2 2272 E-mail: bashkiagramsh@gmail.com

REPublika e Shqiperisë
Bashkia Gramsh
Këshilli Bashkiak

Gramsh, më 29 /08/2025

LISTË PREZENCË E KËSHILLTARËVE BASHKIAK
Mbledhja e Rradhes e Këshillit Bashkiak për Muajin GUSHT 2025

EMER MBIEMER	29 GUSHT 2025	EMER MBIEMER	FIRMA
1- ENIS ZANI	29.08.2025	Enis Zani	
2- VALBONA VERUSHI	29.08.2025	Valbona Verushi	
3- LULJETA DOLLANI	29.08.2025	Luljeta Dollani	
4- KODHEL CALA	29.08.2025	Kodhel Cala	
5- GRETA LENA	29.08.2025	Greta Lena	
6- VISARION BICI	29.08.2025	Visarion Bici	
7- ARDIANA HASA	29.08.2025	Ardiana Hasa	
8- ALKETA BICI	29.08.2025	Alketa Bici	
9- RAMAZAN BRAHO			
10- EDMOND GURI			
11- ERALD ÇARÇIU	29/08/2025	Erald Çarçi	
12- IDRI KOKLA			
13- ERISA ZOGU			
14- KUJTIM BRAHIMI	29/08/2025	Kujtim Brahimi	
15- MARSELA IBRO			
16- ALFRIDA SHAHINI			
17- DALIP HAZIZAJ	29.08.2025	Dalip Hazizaj	
18- ARNILDA DAKARE			
19- BRUNILDA BALLOLLI			
20- FATBARDH ÇEKREZI	29.08.2025	Fatbardh Çekrezi	
21- BRUNILDA GJEVORI	29.08.2025	Brunilda Gjevori	

SEKRETARI I KËSHILLIT
XHULIA GJINI

